



Republika e Kosovës

Republika Kosova - Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada – Government

Ministria e Administratës Publike - Ministarstvo Javne Uprave - Ministry of Public Administration

KATALOGU I PUBLIKIMEVE 2010



Enti i Statistikës së Kosovës (ESK)

Adresa: Rr. Zenel Salihu nr:4, Prishtinë, Kosovë

Tel. 038 235 111

Fax: 038 235 033

E-mail: esk@ks-gov.net

agriculture@ks-gov.net

economic@ks-gov.net

population@ks-gov.net

social@ks-gov.net

Web-faqe: www.ks-gov.net/esk

ISBN 978-9951-575-55-3



ENTI I STATISTIKËS SË KOSOVËS
ZAVOD ZA STATISTIKU KOSOVA
STATISTICAL OFFICE OF KOSOVA

KATALOGU I PUBLIKIMEVE 2010

Katalogimi në botim – (CIP)

Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës

017/019:[061.6(496.51):311

061.6 (496.51):311

Katalogu i publikimeve 2010 / Përgatiten Ramiz Ulaj,
Drita Sylejmani ...[et al.]. - Prishtinë : Enti i Statistikës së
Kosovës, 2010. - 20 f. : ilustr. me ngjyra ; 21 cm.


1. Ulaj, Ramiz, 2.Sylejmani, Drita

ISBN 978-9951-575-55-3

STATISTIKAT SOCIALE

- **Statistikat e Shëndetësisë 2009**

(ESK, tetor 2010) shqip, serbisht, anglisht (48 faqe)



Publikimi Statistikat e shëndetësisë në Kosovë për vitin 2009, përfshinë të dhënat statistikore të shëndetësisë në sektorin publik të Kosovës për vitin 2009. Burimi i të dhënave i këtij publikimi është Instituti Kombëtar i Shëndetësisë (IKSH), si dhe Ministria e Shëndetësisë (MSH). Ky publikim përmban të dhëna për numrin e Institucioneve Shëndetësore, numrin e ipërgjithshëm të punësuarve në këto institucione, kualifikimet shkollore, kualifikimet sipas gjinisë dhe sipas përbërjes etike.

Parathënie

Katalogu i publikimeve të ESK-së ka për qëllim prezantimin figurativ dhe përmbajtësor të të gjitha publikimeve të përgatitura dhe të edituara nga ESK-ja. Këto publikime pasqyrojnë një realitet të qartë të zhvillimit nga fushat relevante, prezantojnë politikat përmbajtësore të gjendjes ekonomike, demografike, vitale, sociale, edukative dhe bujqësore të Kosovës.

Ky katalog përmban të dhëna për publikimet e vitit 2010.

Të gjitha komentet tuaja do të jenë të mirëseardhura të njëjtat mund ti dërgoni në e-mail adresën tonë esk@ks-gov.net. Të gjitha publikimet që gjenden në këtë katalog mund t'i gjeni në ueb faqen tonë në pdf - file www.ks-gov.net/esk.

Broshurën e përgatitën:

Mr.sc. Ramiz Ulaj, Drejtor i Departamentit të TI-së
Znj. Drita Sylejmani, Shefe e sektorit të Shpërndarjes
Znj. Kumrije Beqiri, Zyrtare në sektorin Shpërndarje
Z. Ahmet Cakolli, Zyrtar profesional

Dhjetor, 2010

u.d. Kryeshefi Ekzekutiv i ESK-së,


STATISTIKAT SOCIALE

- **Statistikat e jurisprudencës për persona të mitur 2009**
(ESK, korrik 2010) shqip, serbisht, anglisht (26 faqe)



Sektori i Statistikave të Jurisprudencës ka përgatitur publikimin e të dhënave të statistikave të Jurisprudencës për persona të mitur. Qëllimi i publikimit të këtyre dhënave statistikore është që institucionet vendimmarrës të vendit dhe institucionet tjera të kenë të dhëna sa më gjithëpërfshirëse në sferën e jurisprudencës. Të dhënat kanë të bëjnë me kryesit e veprave penale sipas Gjykatave Komunale dhe të Qarkut.

- **Statistikat e kulturës 2009**
(ESK, Shtator 2009) shqip, serbisht, anglisht (37 faqe)



Publikimi, Statistikat e Kulturës, përmban të dhëna statistikore për vitin 2009, lidhur me aktivitetet kulturore të Kinemave, Teatrove, Galerive, Muzeve, Bibliotekave, Ansambleve, si dhe të dhëna për numrin e të punësuarve nëpër këto institucione. Burimi i të dhënave për statistikat e kulturës janë Drejtoratet e Kulturës Rinisë dhe Sportit në nivele komunale. Për grumbullimin e të dhënave është shfrytëzuar pyetësi i kulturës.

STATISTIKAT SOCIALE

- **Rezultatet e anketës se fuqisë punëtore**

2009

(ESK, korrik 2010) shqip, serbisht, anglisht (39 faqe)



Enti i Statistikës së Kosovës që nga viti 2001 ka filluar publikimin e të dhënave për Anketën e Fuqisë Punëtore në Kosovë. Departamenti i Statistikave Sociale, përkatësisht sektori i statistikave të tregut të punës, përgatitë publikimin mbi raportin hulumtues për statistikën e punësimit dhe papunësisë në Kosovë. Qëllimi i Anketës së Fuqisë Punëtore në Kosovë është që të mbledhë të dhëna statistikore mbi tregun e punës, si dhe të bëjë vlershmin e indikatorëve të punësimit dhe të papunësisë në Kosovë.

- **Statistikat e jurisprudencës për persona madhor 2009**

(ESK, korrik 2010) shqip, serbisht, anglisht (62 faqe)



Të dhënat në këtë publikim kanë të bëjnë me kryesit madhor të veprave penale sipas gjinisë, nacionalitetit, paraqitësin e propozim akuzës, mënyra e zgjidhjes së aktakuzës dhe llojin e dënimit. Të gjitha të dhënat e publikuara janë dhënë sipas kreut përkatës të veprave penale dhe neneve. Të dhënat janë të publikuara në nivel të vendit. Burim i të dhënave për kryesit e veprave penale janë Gjykatat Komunale dhe të Qarkut.

Përmbajtja

Faqe

1. Statistikat e përgjithshme

Katalogu i publikimeve 2010.....	5
Kosova në shifra 2009	5
Buletini tremujor (janar 2010).....	6
Buletini tremujor (prill 2010).....	6
Buletini tremujor (korrik 2010).....	7
Buletini tremujor (tetor 2010).....	7
Kalendari i botimeve 2010	8
Fletëpalosja e ESK-së	8

2. Statistikat e Bujqësisë

Anketa e mbeturinave komunale 2008.....	9
Indeksi i çmimeve të prodhimeve dhe Çmimet në bujqësi 2005-2009.....	9
Indeksi i çmimeve të inputeve dhe Çmimet në bujqësi 2005-2009.....	10
Anketa e ekonomive shtëpiake bujqësore 2008.....	10

3. Statistikat Ekonomike

Bruto produkti vendor (BPV) 2004-2009.....	11
Statistikat e tregtisë së jashtme për vitin 2009.....	11
Indeksi i çmimineve të konsumit për vitet 2002-2009.....	12
Llogarit Qeveritare të Kosovës 2004-2009.....	12

STATISTIKAT SOCIALE

• Statistikat e mirëqenies sociale 2009

(ESK, qershor 2010) shqip, serbisht, anglisht (32 faqe)



Në këtë publikim janë përmbledhur të gjitha të dhënat që kanë të bëjnë për vitin 2009 për përfituesit e ndihmës sociale. Të dhënat për fëmijët e braktisur, për personat e moshuar dhe pa përkujdesje familjare të vendosur në shtëpinë e pleqve, të dhënat për personat me kërkesa të posaçme të vendosur në Institutin e Shtimes. të dhënat për pensionet e pleqërisë dhe pensionet e personave me aftësi të kufizuara, dhënat për familjet e dëshmorëve dhe invalidët e luftës.

• Anketa e buxhetit të ekonomive familjare 2009

(ESK, Qershor 2010) shqip, serbisht, anglisht (22 faqe)



Publikimi i Anketës së buxhetit të ekonomive familjare ofron të dhëna statistikore lidhur me të ardhurat, konsumin si dhe të dhëna statistikore për çështje tjera të ngjashme që kanë të bëjnë me standardin jetësorë të ekonomive familjare në Kosovë. Në këtë publikim janë paraqitur rezultatet në formë përmbledhëse për konsumin, shpenzimet dhe të ardhurat e ekonomive familjare për periudhat 2007-2009.

STATISTIKAT SOCIALE

- **Statistikat e Arsimit në Kosovë 2009/2010**
(ESK, Tetor 2010) shqip, serbisht, anglisht (106 faqe)



Qëllimi i kryesor i këtij publikimi është të informoj Institucionet vendimmarrëse dhe publikun e gjerë me informacione statistikore lidhur me zhvillimin e arsimit kosovarë, duke aplikuar standardet dhe praktikën bashkëkohore lidhur me grumbullimin përpunimin dhe analizimin e të dhënave. Njësitë raportuese për grumbullimin e të dhënave janë: Çerdhet, Kopshtet-para fillore, shkollat e mesme dhe Administrata Qendrore e Universitetit të Prishtinës.

- **Statistikat e Sportit 2009**
(ESK, nëntor 2010) shqip, serbisht, anglisht (60 faqe)



Ky publikim do të na ndihmoj për njohjen dhe vlerësimin me të mirë të edukimit Fiziko-Sportiv në Republikën e Kosovës. Ky publikim përmban të dhëna për numrin e sportistëve si dhe numrin e të punësuarve në Aeronautikë, Atletik, Automobilizëm, Basketboll, Bjeshkatari, Bodi-Bollding, Boks, Çiklizëm, Futboll, Hendboll, karate, Kick-Boks, si dhe të dhëna tjera statistikore të sportit në nivel të vendit.

4. Statistikat e Popullsisë

Statistikat e lindjeve në Kosovë 2009	13
Statistikat e kurorëzimeve në Kosovë 2009.....	13
Statistikat e vdekjeve në Kosovë 2009.....	14
Statistikat e shkurorezeve në Kosovë 2009.....	14

5. Statistikat Sociale

Statistikat e arsimit në Kosovë 2009/2010.....	15
Statistikat e sportit 2009.....	15
Statistikat e mirëqenies sociale në Kosovë 2009.....	16
Anketa e buxhetit të ekonomive familjar 2009.....	16
Rezultatet e anketës se fuqisë punëtore 2009.....	17
Stat. e juris. për persona të madhor 2009.....	17
Stat. e juris. për persona të mitur 2009.....	18
Statistikat e kulturës 2009.....	18
Statistikat e shëndetësisë.....	19

STATISTIKAT E PËRGJITHSHME

- **Katalogu i publikimeve 2009**

(ESK, Dhjetor 2010) shqip, serbisht, anglisht, (28 faqe)



"Katalogu i Publikimeve" të ESK-së ka për qëllim prezantimin figurativ dhe përmbajtësor të të gjitha publikimeve të përgatitura dhe edituara nga ESK-ja.

Publikime këto të cilat prezantojnë politikat përmbajtësore të gjendjes ekonomike , demografike, vitale, sociale, edukative dhe bujqësore të Kosovës.

Katalogu në fjalë përmban të dhëna për publikimet e edituara gjatë vitin 2010.

- **Kosova në Shifra 2009**

(ESK, Prill 2010) shqip, serbisht, anglisht (64 faqe)



Publikimi "Kosova në shifra 2009" është publikim statistikor horizontal. Publikim përmban statistika administrative dhe hulumtuese të përfituara nga anketat e fushave më me rëndësi statistikore.


Publikimi në fjalë prezanton të dhënat themelore statistikore mbi gjendjen socio-ekonomike, demografike dhe bujqësore të Kosovës.

Të dhënat e publikuara janë të vlefshme për vitin 2009.

STATISTIKAT E POPULLSISË

- **Statistikat e vdekjeve në Kosovë 2009**

(ESK, gusht 2010) shqip, serbisht, anglisht (52 faqe)



Enti i Statistikës së Kosovës në këtë publikim, publikon të dhëna bazë, dhe disa indikator për vdekjet në Kosovë për vitin 2009. Të dhënat në këtë publikim janë përfundimtare dhe janë rezultat i hulumtimeve të rregullta mujore, ndërsa përpunimi dhe publikimi i të dhënave janë vjetore. Grumbullimi i të dhënave është bërë përmes instrumenteve të veçanta statistikore : Pyetëtori statistikor, për shkurorëzime DEM-2.

- **Statistikat e shkurorëzimeve në Kosovë 2009**


(ESK, gusht 2010) shqip, anglisht, serbisht (27 faqe)



Enti i Statistikës së Kosovës në këtë publikim, publikon të dhëna bazë, dhe disa indikator për shkurorëzimet në Kosovë për vitin 2009. Të dhënat në këtë publikim janë përfundimtare dhe janë rezultat i hulumtimeve të rregullta mujore, ndërsa përpunimi dhe publikimi i të dhënave janë vjetore. Grumbullimi i të dhënave është bërë përmes instrumenteve të veçanta statistikore: Pyetëtori statistikor, për shkurorëzime SHK-1.


STATISTIKAT E POPULLSISË

- **Statistikat e lindjeve në Kosovë 2009**
(ESK, gusht 2010) shqip, serbisht, anglisht (41 faqe)



Të dhënat në këtë publikim janë përfundimtare dhe janë rezultate i hulumtimeve të rregullta mujore, ndërsa përpunimi dhe publikimi i të dhënave janë vjetore. Të dhënat e statistikave demografike përpunohen dhe publikohen sipas parimit të vendbanimit të përhershëm/zakonshëm të personit, që sipas rregullave ndërkombëtare i përgjigjet konceptonit të popullatës së përhershme.

- **Statistikat e kurorëzimeve në Kosovë 2009**
(ESK, gusht 2010) shqip, serbisht, anglisht (22 faqe)



Të dhënat në këtë publikim janë përfundimtare dhe janë rezultat i hulumtimeve të rregullta mujore, ndërsa përpunimi dhe publikimi i të dhënave janë vjetore. Për shkurozime, njësi raportuese janë Gjykatat e Qarkut të Kosovës. Të dhënat e statistikave për kurorëzime, shkurozime përpunohen dhe publikohen sipas parimit të vendbanimit të përhershëm/zakonshëm të të martuarve gjegjësisht vendbanimit (komunës) të fundit të përbashkët.

STATISTIKAT E PËRGJITHSHME

- **Buletini tremujor, janar 2010**
(ESK, Janar 2010) shqip, serbisht, anglisht (34 faqe)



Publikimi " Buletini Tremujor janar 2010 " është publikim statistikor horizontal me statistika të shumë fushave. Publikimi në fjalë prezanton të dhënat themelore statistikore mbi gjendjen ekonomike, sociale, demografike dhe bujqësore të Kosovës. Të dhënat e publikuara janë të vlefshme për vitin 2008, 2009.

- **Buletini tremujor, prill 2010**
(ESK, Prill 2010) shqip, serbisht, anglisht (34 faqe)



Publikimi " Buletini Tremujor prill 2010 " është publikim statistikor horizontal me statistika të shumë fushave. Publikimi në fjalë prezanton të dhënat themelore statistikore mbi gjendjen ekonomike, sociale, demografike dhe bujqësore të Kosovës. Të dhënat e publikuara janë të vlefshme për vitin 2008, 2009 dhe për tremujorin e parë të vitit 2010.

STATISTIKAT E PËRGJITHSHME

- **Buletini tremujor, korrik 2010**
(ESK, Korrik 2010) shqip, serbisht, anglisht (34 faqe)



Publikimi "Buletini Tremujor, korrik 2009" është publikim statistikor horizontal me statistika të shumë fushave. Publikimi në fjalë prezanton të dhënat themelore statistikore mbi gjendjen ekonomike, sociale, demografike dhe bujqësore të Kosovës. Të dhënat e publikuara janë të vlefshme për vitin 2008, 2009 dhe për tremujorin e dytë të vitit 2010.

- **Buletini tremujor, tetor 2010**
(ESK, Tetor 2010) shqip, serbisht, anglisht (34 faqe)



Publikimi "Buletini tremujor tetor 2010", është publikim statistikor horizontal me statistika të shumë fushave. Publikimi në fjalë prezanton të dhënat themelore statistikore mbi gjendjen ekonomike, sociale, demografike dhe bujqësore të Kosovës. Të dhënat e publikuara janë të vlefshme për vitin 2008, 2009 dhe tremujorin e tretë të vitit 2010.

STATISTIKAT EKONOMIKE

- **Indeksi i çmimeve të konsumit 2002-2009**
(ESK, qershor 2010) shqip, anglisht, serbisht (44 faqe)



ESK përkatësisht divizioni i statistikave të çmimeve përgatiti publikimin për Indeksin e çmimeve maj 2002 dhjetor 2009. Indeksi i Çmimeve të Konsumit (IÇK) është tregues relativ që paraqet dinamikën e ndryshimeve apo lëvizjen e çmimeve me pakicë për artikujt e shërbimet më reprezentues të konsumuar nga ekonomitë familjare në periudhë të caktuar kohore të përfshirë në grupe dhe në ngrupe të klasifikuara sipas Nomenklaturës ndërkombëtare të ashtuquajtur COICOP (Klasifikimi i konsumit individual sipas destinimit).

- **Llogarit Qeveritare të Kosovës 2004-2009**
(ESK, qershor 2010) shqip, serbisht, anglisht, (28 faqe)



Enti i Statistikës së Kosovës (ESK), respektivisht Departamenti i statistikave ekonomike dhe llogarive kombëtare ka përgatitur publikimin "Llogaritë Qeveritare të Kosovës 2004-2009". Ky botim paraqet pasqyrën e të hyrave dhe shpenzimeve qeveritare brenda kësaj periudhe.

ESK-ja i është mirënjohës Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave (MEF), Trustit të Kursimeve Pensionale të Kosovës (TKPK) si dhe Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës (BQK) për ofrimin e të dhënave në lidhje me këtë publikim.

STATISTIKAT EKONOMIKE

- **Bruto produkti vendor (BPV) 2004-2009**
(ESK , nëntor 2010) shqip, serbisht, anglisht, (6 faqe)



Në këtë publikim janë paraqitur llogaritjet paraprake të Bruto produktit vendor me çmimet aktuale për vitet 2004-2009 që janë përlogaritur nga sektori i llogarive kombëtare në ESK. BPV sipas qasjes së prodhimit, është shuma e bruto vlerës së shtuar e të gjitha njësive prodhuese rezidente, plus tatimet e zvogluara për subvencionet në prodhim të cilat nuk janë të përfshira në vlersimin e outputit.


- **Statistikat e tregtisë së jashtme 2009**
(ESK , qershor 2010) shqip, serbisht, anglisht, (38 faqe)



Publikimi për tregtinë e jashtme është i bazuar në të dhënat e Shërbimit Doganor të Kosovës dhe Korporatës Energjetike të Kosovës, për energji elektrike. Të dhënat në këtë publikim ndryshojnë nga të dhënat paraprake të publikuara për vitin 2009. Importet janë paraqitur sipas vendit të origjinës së mallit. Në këtë publikim krahasuar me publikimet e mëparshme kemi shtuar edhe disa tabela të reja të cilat paraqesin këmbimin tregtarë të vendit tonë me partnerët kryesor .

STATISTIKAT E PËRGJITHSHME

- **Kalendari i botimeve 2010**
(ESK, 2010) shqip, (4 faqe)



Kohë pas kohe ESK shpërndanë informacione dhe deklarata për shtyp. Këto forma sjellin për përdoruesit informacion shumë të rëndësishëm të tipit strukturor mbi të dhënat ekonomike, demografike, sociale dhe bujqësore në nivel vendi. Ky kalendarë në vete përmban datat e publikimeve të parapara paraprakisht për publikime që pritet të publikohen gjatë vitit vijues.

- **Fletëpalosja e ESK-së**
(ESK, dhjetor 2010)



ESK është agjencion i pavarur në kuadër të Ministrisë së Administratës Publike (MAP). Misioni i Entit është përmbushja e kërkesave të shfrytëzuesve për statistika objektive dhe analiza, ti përkrahë ministritë e qeverisë dhe të sigurojë informata të caktuara për vendim-marrësit dhe shfrytëzuesit e tjerë në Kosovë.

STATISTIKAT E BUJQËSISË

- **Anketa e mbeturinave komunale 2008**
(ESK, Dhjetor 2009) shqip, serbisht, anglisht (18 faqe)



Enti i Statistikës së Kosovës, konkretisht Departamenti i Statistikës së Bujqësisë dhe Mjedisit për herë të tret ka realizuar Anketën e Mbeturinave Komunale. Qëllimi i kësaj ankete është që të siguroi të dhëna statistikore të qëndrueshme për sektorin e mbeturinave Komunale në Kosovë. Rezultatet e prezantuar në këtë publikim ofrojnë një burim të rëndësishëm statistikor për gjendjen e tanishme të këtij sektori.

- **Indeksi i çmimeve të prodhimeve dhe çmimet në bujqësi 2005-2009**
(ESK, Shkurt 2010) shqip, serbisht, anglisht (30 faqe)



Statistikat e Bujqësisë dhe të Mjedisit, kanë filluar të grumbulloj të dhënat për çmimet e prodhimeve bujqësore që nga nëntori i vitit 2003. Aktualisht çmimet grumbullohen për 64 prodhime të ndryshme bujqësore. Ky publikim është i njëmbëdhjetë me radhë mbi indeksin e çmimeve të prodhimeve bujqësore dhe çmimet mesatare absolute të prodhimeve bujqësore. përgatitur nga ESK.-ja.

STATISTIKAT E BUJQËSISË


- **Indeksi i çmimeve të Inputeve dhe Çmimet në Bujqësi 2005-2009**
(ESK, Qershor 2010) shqip, serbisht, anglisht (24 faqe)



Statistikat e Bujqësisë dhe të Mjedisit, kanë filluar të grumbulloj të dhëna për çmimet e inputeveve bujqësore në nëntor të vitit 2003. Aktualisht çmimet grumbullohen për 68 inpute të ndryshme bujqësore.

Ky publikim është i pari mbi indeksin e çmimeve të inputeve dhe çmimet mesatare absolute të inputeve bujqësore përgatitur nga Enti Statistikor i Kosovës (ESK).

- **Anketa e ekonomive shtëpiake bujqësore 2008**
(ESK, Gusht 2010) shqip, serbisht, anglisht (52 faqe)



Kjo është anketa e tetë me radhë e ekonomive shtëpiake bujqësore të cilën e realizon ESK-ja, konkretisht Departamenti i Bujqësisë dhe Ambientit. Qëllimi i kësaj ankete është që të sigurohen të dhëna statistikore për sektorin e bujqësisë në Kosovë. Rezultatet e kësaj ankete ofrojnë një burim të rëndësishëm të informatave mbi gjendjen e tanishme të bujqësisë në Kosovë.